THE FORINA SPEECH VARIETY AND THE DIALECT GROUPS OF ALBANIAN

E FOLMJA E FORINËS DHE GRUPET E TË FOLMEVE

Adelina XHAFERI*, Egzon XHAFERI**

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe & Shkolla Fillore "Forina", Forinë, Gostivar***
adelina.xhaferi@unite.edu.mk & egzonxhaferi91@gmail.com

Abstrakti

Gjuha Shqipe është një ndër gjuhët më të vjetra, më të larmishme, më të mbushura dhe më të bukura në botë, sepse brenda vetes së saj janë krijuar mjaft elemente të veçanta dhe të ndryshme, të cilat e paraqesin si të kaluarën e saj, ashtu edhe të sotmen dhe të nesërmen. Në këtë mes, me karakteristika të ndryshme dhe mjaft të larmishme (të dukshme) gjuhësore del edhe e folmja shqipe e fshatit Forinë të qytetit të Gostivarit (Republika e Maqedonisë së Veriut), e cila duke u parë me të gjitha grupet e të folmeve shqipe del me pika (elemente) të përbashkëta. Ndaj, nëpërmjet kësaj kumtese, duke e shfrytëzuar metodën e deduksionit dhe metodën e krahasimit, do të shihet se si dalin pikat e përbashkëta ndërmjet të folmes së Forinës dhe gegërishtes verilindore, gegërishtes veriperëndimore, gegërishtes qendrore, gegërishtes së Shqipërisë së Mesme, toskërishtes veriore, toskërishtes jugore, çamërishtes, labërishtes, të folmes së shqiptarëve të diasporës, arbëreshëve të Italisë, arbëreshëve të Greqisë, arbëreshëve të Zarës, të folmes së shqiptarëve të Ukrainës, apo të folmes së kelmendasve të Peshterit. Të gjitha këto grupe të të folmeve, ashtu siç do të shihet edhe më poshtë kanë karakteristika të ndryshme gjuhësore, të cilat në këtë punim do të jepen në formën e tyre të rregullt drejtshkrimore dhe në formën dialektore për të folmen e Forinës.

Fjalët çelës: dialektologjia, e folmja, grupi i të folmeve, Forina, e përbashkëta

Abstract

The Albanian language is one of the oldest, most diverse, richest, and most beautiful languages in the world, as it encompasses numerous distinctive and diverse linguistic features that reflect its past, present, and future. Among its many linguistic varieties, the Albanian speech variety of the village of Forina, in the municipality of Gostivar (Republic of North Macedonia), stands out for its diverse and distinctive linguistic characteristics. When examined in relation to the various groups of Albanian speech varieties, it reveals several common linguistic features. Therefore, through this study, by employing the methods of deduction and comparison, the shared features between the speech variety of Forina and the following Albanian speech varieties will be identified and examined: Northeastern Gheg, Northwestern Gheg, Central Gheg, the Gheg variety of Central Albania, Northern Tosk, Southern Tosk, the Cham variety, the Lab variety, the speech of the Albanian diaspora, the Arbëresh varieties of Italy and Greece, the Albanian variety Zadar, the speech varieties of Albanians in Ukraine, and the speech variety of the Kelmendi of Peshter. As will be demonstrated in the following sections, all these groups of speech varieties exhibit distinct linguistic characteristics. In this study, these characteristics will be presented both in their standard orthographic forms and in their dialectal forms as used in the speech variety of Forina.

Keywords: dialectology, speech variety, group of speech varieties, Forina, shared features

1. Hyrja

Nga njohuritë e përgjithshme e të veçanta të fushës së dialektologjisë, dihet se dialektologjia është një degë mjaft e rëndësishme e gjuhësisë, e cila në vetveten e saj merret me studimin e dialekteve territoriale, d.m.th., me studimin e gjuhës së folur popullore. Me këtë studim, studiuesve dhe lexuesve të studimeve të ndryshme u jepet një pasuri mjaft e madhe popullore, si dhe një pasqyrim i drejtë se në ç'gjurmë dhe shkallë ka ecur një popull i caktuar. Në këtë mënyrë del që dialektologjia si degë e gjuhësisë i studion të gjitha variantet gjeografike të një gjuhe të përbashkët, të cilën shoqëria njerëzore ka arritur që ta zhvillojë dhe ta sjellë deri në ditët e sotme. "Termi dialektologji, ashtu si numri më i madh i termeve tjera rrjedh nga greqishtja e vjetër, duke u përbërë nga këto fjalë themelore: ***dialektos -*** *e folme/bisedë* dhe ***logos***

- *shkencë/dije".*[1] Si degë e gjuhësisë dialektologjia është e aftë që ta studiojë dialektin duke e parë atë nga etapat e hershme historike (pra dialektologjia diakronike), apo vetëm për gjendjen e dialektit në të sotmen (pra dialektologjia sinkronike) e tij.
Duke u ditur se gjuha e njerëzve është një qenie e gjallë me rregulla dhe njësi të caktuara, e cila çdo ditë e më shumë pëson ndryshime nga më të ndryshmet, duhet të jetë e qartë se dialektologjia, përfshirë në veçanti edhe dialektologjinë shqiptare, është rurale (pra merret me studimin e të folmes së fshatrave të ndryshëm), ngaqë qytetet (apo pjesa urbane) nuk merren si fusha studimi për të. Në këtë mënyrë menjëherë kuptohet se dialektologjia brumin e saj e merr nga e folmja e fshatrave dhe se prej tyre e paraqet zhvillimin dhe larminë e të folurit njerëzor. Me njohjen e këtyre karakteristikave kryesore të kësaj dege të shkencës së gjuhësisë, duhet ditur se në dialektologji nuk ka kufij të prerë gjeografikë, por ka kufij të përafërt, duke u ditur se një element i caktuar i një hapësirë të veçantë e paraprake, gjendet (haset) edhe në një hapësirë tjetër gjeografike, qoftë të afërt, apo edhe më të largët. Në këtë rast ajo që nxitet për t'u njohur nuk është vetëm e folmja (gjuha) e një hapësire të caktuar, por edhe njohja e asaj se cila hapësirë e ka krijuar një të folme të caktuar dhe se si elemente të saj kanë kaluar edhe në hapësirat tjera, pa u ditur në të vërtetë se në cilën hapësirë janë krijuar. Ndaj, duhet pohuar se gjuha e qenies njerëzore në realizimin e saj të folur ndryshon në bazë të faktorëve të ndryshëm shoqërorë, siç janë: "mosha e folësve, gjinia, shkalla e arsimit, profesioni i (pa)ushtruar, besimi fetar apo edhe vetë bashkëbiseduesi"[2]. Dallimet të cilat dalin duke u njohur këta faktorë të shumtë e të ndryshëm quhen dallime sociale (shoqërore).

2. Rezultatet dhe diskutimet

Grupet e të folmeve

Grupi i të folmeve është pjesë e nëndialektit. Si i tillë, e jep pamjen e qartë për atë se ç'duhet të nxirret, përfshirë studimet në fusha të caktuara të gjuhësisë. Nëndialektet e shqipes japin një larmi të madhe të grupeve të të folmeve, të cilat do të jepen me nënndarjet e mëposhtme:

Gegërishtja verilindore - E folmja e Forinës

"Grupi i të folmeve të gegërishtes verilindore shpesh emërtohet si kosovarishte, sepse pjesa më e madhe e të folmeve të këtij grupi shtrihet në hapësirën e Kosovës, Bujanovcit dhe Preshevës. Ky grup i të folmeve e përfshinë: të folmen e Kumanovës, të folmen e Krasniqes, të folmen e rrethit të Tropojës, të folmen Hasit dhe të folmen e Pukës".[3] Disa nga pikat e përbashkëta të këtij grupi të të folmes me atë të fshatit Forinë të qytetit të Gostivarit do të radhiten si më poshtë:

- E kanë serinë e zanoreve të shkurtra dhe të gjata: ***pjak*** (plak) - ***pja:k*** (plakë), ***kos*** (prodhim qumështi) - ***ko:s*** (mjet pune, mjet bujqësor) etj;
- E ruajnë /*n*/-në ndërzanore të shqipe së vjetër: ***seni*** (syri), ***peni*** (peri), ***lakna*** (lakra), ***hona*** (hëna), ***buona*** (bëra) etj;
- E kanë përdorimin e vargut [*vo*] në fillim të fjalëve: ***voj*** (vaj), ***vorr*** (varr), ***votër*** (vatër) etj;
- Mungesë të zanores /*ë*/ të theksuar, apo përdorim mjaft të kufizuar i /*ë*/- së patheksuar;
- Kanë përemra dëftorë me formë të përngjitur: ***çeki*** (ja ky), ***çekjo*** (ja kjo), ***çekto*** (ja këto), ***çaj*** (ja ai), ***çajo*** (ja ajo), ***çato*** (ja ata/ato) etj;

[1] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 13.
[2] Po aty, f. 16.
[3] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 197.

- Kanë pjesore të reduktuar (të shkurtuar, të cunguar, pa mbaresa): ***kum*** (kam) ***buo*** (bërë), ***la*** (larë), ***pa:*** (parë), ***fshe:*** (fshirë), ***me:ll*** (mbjellë), ***the:*** (thyer), ***bji:*** (blerë), ***mso:*** (mësuar), ***puno:*** (punuar), ***pre:*** (prerë), ***ne:t*** (qëndruar) etj;
- Grupet e bashkëtingëlloreve *-mb*, *-nd* dhe *-ng*, janë asimiluar në fonemat e para [*-m*, *-n*]: ***ma:j*** (mbaj), ***mush*** (mbush), ***dhom*** (dhëmb) etj;
- E pakryera e tyre si kohë është sigmatike: ***un punuojsha*** (unë punoja) - ***ne punuojshim*** (punonim);
- Kanë trajtë të së pakryerës me të tashmen e foljes jam + pjesore: ***kom erdh*** (kam ardhur), ***kom qon*** (kam qenë), ***kom shko:*** (kam shkuar) etj.

Gegërishtja veriperëndimore - E folmja e Forinës

"Të folmet veriperëndimore të shqipes shtrihen në të folmen e Kelmendit, të folmen e Hotit, të folmen e Kastratit, të folmen e Shkrelit, të folmen e Temalit, të folmen e Shkodrës, të folmen e Zadrimës, pra në Malësinë e Madhe, Dukagjin, Mbishkodër, Plavë, Guci, Ulqin me të folmet tjera të Malit të Zi".[4] Disa nga pikat e përbashkëta të këtij grupi të të folmes me atë të të folmes së Forinës janë si më poshtë:

- E kanë serinë e zanoreve të gjata dhe të shkurtra, zanoreve gojore;
- Përdorimi i formave përemërore: ***gjali jem*** (djali im)*,* ***coca*** *(vajza)* ***jeme*** *(ime)* në vetën e parë, kur prona dhe pronari janë në numrin njëjës;
- Kanë mungesë të fonemës /*-ë*/ të theksuar;
- Bashkëtingëlloret mesgjuhore [*q*] dhe [*gj*] kanë kaluar në [*ç*] dhe [*xh*]: ***ça:f*** (qafë), ***çen*** (qen), ***çiri:*** (qiri), ***xhak*** (gjak), ***xhum*** (gjumë), ***xharpën*** (gjarpër), ***xhieth*** (gjeth);
- Grupet e bashkëtingëlloreve *-mb*, *-nd*, *-ng* kanë kaluar në *-m* dhe *-n*;
- Ruhen grupet e zanoreve [*ue*, *ie*]: ***grue*** (grua)***, diell*** etj;
- E kanë mbaresën /*u*/, për vetën e parë njëjës të së tashmes te foljet me temë në -k, -g: ***hiku*** (u largua, u arratis)***, lagu*** (u lag) etj.

Gegërishtja qendrore - E folmja e Forinës

"Në të folmen e gegërishtes qendrore përfshihen këto vende: Fushë-Kruja, Kruja, Malësia e Madhe, Mati, Mirdita, Peshkopia, Shkupi, Kumanova, pjesa lindore dhe veriore e Strugës, disa fshatra të Tetovës, Shkupit, Dibrës, Gostivarit, Prilepit, Kërçovës dhe të tjera".[5] Pikat e përbashkëta të kësaj të folmeje me atë të fshatit Forinë, jepen si vijon më poshtë:

- Në huazimet orientale theksi zhvendoset nga rrokja fundore në rrokjen parafundore: ***baklla:v*** (bakllava), ***ba:b*** (baba), ***tenieçe*** (teneqe) etj;
- Kanë kundërvënie të zanoreve të gjata me ato të shkurtrat: ***ka*** (folje) - ***ka:*** (kafshë) etj;
- Shqiptimi i zanores /*-ë*/ të theksuar: ***shtërk*** (lejlek), ***gërbe*** (kurriz), ***sërb*** (serb) etj;
- /Ë/-ja del me denduri të vogël përdorimi dhe është mjaft e paqëndrueshme; ajo nuk përdoret as në fillim dhe as në fund të fjalës: ***duor*** (dorë), ***bo:rr*** (burrë), ***pja:k*** (plakë), ***dishek*** (dyshek), ***tli:*** (tëlyen), ***malse:*** (malësi), ***liko:r*** (lëkurë) etj;
- Labializimi i /*a*/-së hundore në /*o*/: ***koma*** (kama/këmba), ***hona*** (hana/hëna), ***bona*** (bana/bëra), ***nona*** (nana/nëna) etj;
- Ruhen grupet e vjetra *-ae*, *-oe*: ***m'pae*** (më pe), ***m'dhae*** (më dhe), ***m'thae*** (më the), ***m'lae*** (më le), ***voe*** (vezë), ***rae*** (re), ***hae*** (haje), ***dae*** (ndaje) etj;
- Palatalizimi i grupit *-dj* në *-gj*: ***gjal*** (djalë), ***gjiers*** (djersë), ***gjieg*** (djeg);
- Grupet -tj dhe -dj, dalin si -q dhe -gj: ***qietri*** (tjetri), ***gjath*** (djathë), ***gjal*** (djalë), ***gjiers*** (djersë), ***aqe*** (atje) etj;

[4] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 202/ 203.
[5] Po aty, f. 206.

- Grupe e bashkëtingëlloreve -pl, -bl, -fl janë shndërruar në -pj, -bj, -fj: ***pjak*** (plak), ***pjot*** (plotë), ***bje:t*** (bletë), ***bju:j*** (bluaj), ***fjaka*** (flaka), ***fjutur*** (flutur), ***fjo:k*** (flokë) etj;
- Emrat e gjinisë mashkullore që në trajtën e pashquar mbarojnë me *-k, -g, -h,* trajtën e shquar e formojnë me mbaresën *-u*: ***pjaku*** (plaku), ***oku*** (ujku), ***ibriku*** etj;
- Përemra dëftorë i kanë në formë të përngjitur;
- Nuk bëhet dallimi ndërmjet përemrave vetorë ato/ata, pra ata përdoren njëjtë;
- Foljet e zgjedhimit të dytë, të dy klasat në vetën e parë njëjës në kohën e tashme të dëftores dalin me mbaresën /*i*/: ***un*** (unë) ***foli***, ***fugi*** (hedh), ***preshi*** (prishi), ***lidhi***, ***mushi*** (mbushi), ***heci*** (ec), ***bji*:** (blej), ***me:lli*** (mbjell) etj;
- Foljet me temë në zanore në vetën e tretë njëjës të së tashmes së lidhores dalin me mbaresën *-(j)e*: ***aj*** (ai) ***t'kaluoje*** (të kalojë), ***t'punuoje*** (të punojë), ***t'ngjuoje*** **(**të dëgjojë), ***t'kënduoje*** (të këndojë), ***t'msuoje*** (të mësojë). Ndërkaq, edhe foljet me temë në bashkëtingëllore dalin me mbaresën /-e/: ***aj*** (ai) ***t'hece*** (të ecë), ***t'melle*** (të mbjellë) etj.

Gegërishtja e Shqipërisë së Mesme - E folmja e Forinës

"Të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme janë të folmet e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit. Në veri kjo e folme kufizohet me të folmet e gegërishtes qendrore, ndërsa në jug me të folmet kalimtare"[6]. Pikat e përbashkëta të kësaj të folmeje me atë të Forinës janë si më poshtë:

- Në çdo pozitë dhe në të gjitha rastet pa përjashtim, togjet e zanoreve monoftongohen në zanore të thjeshta: ***mu:*** (mua), ***u zi:*** (u zie), ***u li:*** (u lye), ***u the:*** (u thye) etj;
- Zanorja *-a* hundore buzorëzohet në *-o*: ***nona*** (nana/nëna), ***buona*** (bana/bëra);
- Është karakteristike përdorimi i rasës vendore: ***n'mol*** (në mal), ***n'gruop*** (në gropë), ***n'fo:sh*** (në fushë), ***me lu:g*** (me lugë), ***mbi gur, nëpër misër, nëpër uj*** (nëpër ujë) etj;
- Përdorim të dendur ka mënyra lidhore: ***t'punuoj*** (të punoj), ***t'msuoj*** (të mësoj), ***t'bie*** (të bi), ***t'kiem*** (të kem), ***t'di*** (të di), ***t'hiki*** (të iki) etj.

Të folmet kalimtare - E folmja e Forinës

"Të folmet kalimtare ndodhen në një zonë ndërmjet dy dialekteve të shqipes, me tipare të përziera, përreth lumenjve Shkumbin dhe Drinit të Zi. Në këtë grup të folmesh hyjnë vendet: Rajca, Polisi, Darsia e Pelqinit, bregdeti i poshtëm i Kavajës dhe fusha veriore e Lushnjës".[7]. Ky grup i të folmes ka disa pika të përbashkëta me atë të Forinës, edhe atë:

- Zanorja e theksuar hundore -a buzorëzohet në *-o*: ***zo:*** (za/zë), ***xho:*** (gja/gjë) etj;
- Përdorimi i togut *-vo* në fillim të fjalëve të ndryshme;
- Përdorimi i dendur i rotacizmit: ***lakno:r*** (lakror), ***dimën*** (dimër), ***femën*** (femër) etj.

Toskërishtja veriore - E folmja e Forinës

"Toskërishtja veriore shtrihet në rrethet e Beratit, Fierit, Skraparit, Pogradecit, Korçës, Tepelenës, Përmetit, Strugës, Prespës, Manastirit".[8] E folmja e Forinës ka pika të përbashkëta edhe me toskërishten veriore, siç janë këto më poshtë:

- Zanorja hundore -e nuk ka kaluar në të gjitha rastet në -ë, por në disa ka mbetur si e tillë, pra si -e hundore: ***pe:ni*** (peri), ***fre:ni*** (freri), ***femën*** (femër)***, e ejte*** (e enjte);
- Bashkëtingëlloret e zëshme në pozitë fundore shurdhohen: ***zuok*** (zog), ***vent*** (vend), ***ment*** (mend), ***zemër*** etj,

[6] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 211.
[7] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 212/213.
[8] Po aty, f. 214.

- Format e së pakryerës të foljeve në dëftore: ***isha, ishe, ishte, ishim, ishit, ishin***;
- Ruhet rasa vendore: ***n'mol*** (në mal), ***n'fo:sh*** (në fushë), ***n'kreje*** (në kokë), ***n'grop*** (në gropë), ***n'dier*** (në derë) etj.

Toskërishtja jugore - E folmja e Forinës

"Toskërishtja jugore shtrihet në Labëri, në anën e Gjirokastrës, Delvinës dhe në Çamëri".[9] Pikat e përbashkëta që ka kjo e folme me atë të Forinës, po jepen në shembujt e mëposhtëm:

- Mungon zanorja -y, meqë është shndërruar në -i: ***di*** (dy), ***ilbier*** (ylber), ***ill*** (yll), ***ki*** (ky), ***qip*** (qyp) etj;
- Në pozitë fundore bashkëtingëllorja -nj ka kaluar në -j te mbaresat e foljeve dëftore të kohës së tashme e në format e të së pakryerës, si p.sh: ***laj, punuoj*** (punoj)***, shkuoj*** (shkoj); ***t'punuoj*** (të punoj), ***t'punuoje*** (të punojë), ***t'punojshim*** (të punonim).

Labërishtja - E folmja e Forinës

"Labërishtja i përfshin të folmet e Vlorës, Gjirokastrës, Lunxhërisë dhe të Kurveleshit".[10] Kjo e folme ka edhe disa pika të përbashkëta me të folmen e Forinës, siç jepen më poshtë:

- Zanorja -y është zhbuzorëzuar në -i;
- Grupet e bashkëtingëlloreve -mb, -nd, -ng janë asimiluar në -m, -n.

Çamërishtja - E folmja e Forinës

"Çamëria është krahinë e madhe gjeografike në pjesën më jugore të trevave të banuara prej shqiptarëve. Me vendimet e Konferencës së Londrës (1913) pjesa më e madhe e saj iu dha Greqisë".[11] Pikat e përbashkëta ndërmjet çamërishtes dhe të folmes së Forinës shihen në:

- Ruajtja e zanoreve të gjata, si: ***u:od*** (dhomë), ***xhi:z*** (gjizë), ***vo:e*** (vezë), ***shpe:*** (shtëpi), ***die:t*** (det), ***kom fshe:*** (kam fshirë), ***kom pre:*** (kam prerë), ***kom pe:*** (kam pirë) etj;
- Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore; ruhet gjinia asnjanëse;
- Bashkëtingëllorja -h ruhet në çdo pozicion: ***ho:n*** (hënë)***, at'her*** (atëherë), ***ha:ll*** (hallë) etj;
- Në togfjalëshat emër + emër në rasën gjinore, apo emër + mbiemër i nyjshëm zanorja e patheksuar -ë elidohet në fund të fjalës: ***kohe: vjietër*** (kohë e vjetër), ***buzë: moli*** (buzë e malit), ***kollce: mullenit*** (rrota e mullirit) etj.

Të folmet shqipe të diasporës - E folmja e Forinës

"Diasporës së moçme shqiptare i përkasin arbëreshët e Greqisë dhe të Italisë (*të shpërngulur grupe-grupe nga pjesët jugore të Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut, nga shekulli XV dhe shekulli XVI; u vendosën kryesisht në Kalabri e Sicili*), Ukrainës, Bullgarisë dhe të Kroacisë. Për arsye ekonomike, politike dhe fetare janë krijuar edhe diaspora të reja shqiptare pas shekullit XVIII, si në: Turqi, Egjipt, Amerikë, Zvicër etj. Të folmet arbëreshe janë ishuj gjuhësorë në fshatrat arbëreshe të Italisë së Jugut dhe në fshatrat arvanitase të Greqisë. Këto i përkasin toskërishtes dhe paraqesin mjaft veçori gjuhësore që i bashkojnë me të folmet e toskërishtes jugore, labërishten dhe çamërishten".[12]

[9] Po aty, f. 215.
[10] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, 216.
[11] Po aty, f. 217/218.
[12] Po aty, f. 221/223/228/229.

E folmja e arbëreshëve të Italisë - E folmja e Forinës

"Gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqet një formë më vete, prandaj është quajtur edhe dialekti i tretë i shqipes". [13] Kjo e folme i përket toskërishtes jugore dhe duke qenë se është në kontakt të vazhdueshëm me Gjuhën Italiane, duhet pranuar që pësoi ndryshime dhe mjaft ndikime nga ajo gjuhë. Arbëreshët e Italisë arbërishten e kanë**,** siç e quajnë ata *"gjuhë të zemrës",* ndërsa italishten *"gjuhë të bukës".*[14] Ata ende i ruajnë traditat e të parëve të tyre, siç janë: gjuha, veshja, riti dhe doket e mëmëdheut. Nga gjiri i tyre kanë dalë mjaft emra të zëshëm të cilët kanë kontribuar në fusha të ndryshme të gjuhës, letërsisë, historisë dhe në fusha të tjera. Veçoritë gjuhësore, të cilat i nxjerrin edhe pikat e përbashkëta të kësaj të folmeje me atë të Forinës, po sillen në shembujt e mëposhtëm:

- Kanë fonema zanore të gjata: ***pjak*** (plak) ***- pja:k*** (plakë) etj;
- Prania e rotacizmit;
- Fonema -y e zhbuzorëzuar në -i;
- Ruhet rasa vendore (lokativi).

E folmja e arbëreshëve të Greqisë - E folmja e Forinës

"Arbëreshët e Greqisë janë të shpërngulur nga tokat e Moresë që nga koha kur ajo ra në duart e turqve (shekulli XII dhe shekulli XIV). Ata u shpërngulën nga pjesa jugore e Shqipërisë dhe u vendosën në vende të ndryshme greke të pabanuara në periudhën ndërmjet shekujve XI dhe XV".[15] Veçoritë gjuhësore në fushë të fonetikës dhe të morfologjisë, të cilat i ka kjo e folme në fjalë me të folmen e Forinës së qytetit të Gostivarit dhe që dalin si pika të përbashkëta, po jepen të radhitura si më poshtë:

- Mungon fonema -y meqë ka kaluar në fonemën -i: ***di*** (dy), ***brima*** (bryma), ***illi*** (ylli) etj;
- Ruhet grupi i zanoreve -ie: ***bie, fie*** (ti fle), ***kie*** (ti ke), ***die*** (dije!);
- Bashkëtingëlloret e zëshme, ashtu si në mbarë toskërishten, edhe në këto të folme shurdhohen: ***zuok*** (zog), ***katont*** (katund), ***ment*** (mend) etj;
- Ruhet gjinia asnjanëse;
- Ruhet forma e gjinisë asnjanëse për pronorët: ***jiem*** (im), ***jieme*** (ime).

E folmja e arbëreshëve të Zarës - E folmja e Forinës

"Për arsye të ndryshme politike dhe ekonomike, grupe masive shqiptarësh janë shpërngulur nga trojet e tyre për të zënë vend në ish - vendet e Jugosllavisë. Kolonia e shqiptarëve të Dalmacisë/Kroacisë u themelua nga fillimi i shek. XVIII, me banorët e Malësisë së Shkodrës. Njeriu në zë që vjen nga kjo koloni është ilirologu i njohur, Aleksandër Stipçeviq". [16] Pikat e përbashkëta të cilat i ka e folmja e Forinës me të folmen në fjalë, po jepen më poshtë:

- Zanorja -a është buzorëzuar në -o;
- Nuk shqiptohet ë-ja fundore;
- Bashkëtingëllorja -rr është zbutur në -r;
- Emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresën -i ose -u, ato femërore -a ose -ja: ***gjali*** (djali), ***sheni*** (shiu), ***meni*** (miu), ***nona*** (nëna), ***xhoja*** (gjëja), ***guoja*** (goja) etj;
- Koha e kryer e thjeshtë e foljeve formohet me mbaresën e-va: ***shkova, kërceva*** etj.

[13] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 224.
[14] Po aty.
[15] Po aty, f. 229/230.
[16] Asllan Hamiti, Ajtene Qamili, (2014), Dialektologjia e gjuhës shqipe, UlShM, Shkup, f. 233.

E folmja e shqiptarëve të Ukrainës - E folmja e Forinës

"Ngulmim shqiptarësh të shpërngulur ka edhe në Ukrainë, të cilët janë me origjinë toske nga Shqipëria juglindore (ana e Korçës dhe ana e Devollit). Ata jetojnë në katër fshatra heterogjene. Veten e quajnë arnautë dhe gjuhën e tyre arnautçe. Krahas shqipes ata e dinë edhe rusishten, meqë edhe mësimin e ndjekin në atë gjuhë".[17] Pikat e përbashkëta të cilat i ka kjo e folme në fjalë me atë të Forinës së Gostivarit, jepen të dhëna si më poshtë:

- Monoftongohen grupet e zanoreve -ua, -ye, -ie në -u, -e, -i: ***du:*** (dua), ***mu:j*** (muaj), ***lu:j*** (luaj), ***pe:s*** (pyes), ***duo:r*** (duar), ***me:ll*** (miell) etj;
- Bashkëtingëllorja -rr është zbutur në -r: ***rall*** (rrallë), ***fo:r*** (furrë), ***ondër*** (ëndërr), ***dra:s*** (dërrasë), ***riedh*** (rrjedh), ***re:*** (rri) etj;
- Bashkëtingëlloret shurdhohen në pozitë fundore të fjalës;
- Ruhet rasa vendore.

E folmja e kelmendasve të Peshterit - E folmja e Forinës

Kelmendasit e Peshterit (skaji jugperëndimor i Serbisë, në kufi me Malin e Zi, me 14 fshatra) janë me origjinë nga Malësia e Madhe, gjegjësisht nga rreth i Shkodrës, të cilët u shpërngulën pas ekspeditave të shumta të ushtrisë turke (në vitin 1700/1702). E folmja e Forinës ka disa pika të përbashkëta edhe me këtë të folme, ndër to mund të numërohen:

- E kanë serinë e zanoreve të gjata dhe të shkurtra;
- Kanë zanore hundore: ***pe:*** (pe), ***fre:*** (fre), ***he:*** (hi), ***se:*** (sy), ***dri:*** (dry) etj;
- Bashkëtingëllorja -h shqiptohet në çdo pozicion të fjalës;
- Ruhen ndërdhëmboret -th, -dh: ***theka*** (thika), ***thot*** (thotë), ***katërdhet*** (dyzet) etj;
- Ruhet grupi -fsh: ***fshe:*** (fshi), ***fsho:j*** (fshaj), ***quofsha!*** (qofsha!) etj;
- Bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës shurdhohen;
- Emrat mashkullorë në kallëzore marrin mbaresën -in: ***zonin*** (zërin), ***senin*** (syrin) etj;
- Përemri dëftor del me formë të përngjitur: ***çeki*** (ja ky), ***çekjo*** (ja kjo), ***çato*** (ja ato).

3. Konkluzionet

Nga të gjitha pjesët e para në rrjedhë të këtij punimi shkencor, shihet se e folmja e fshatit Forinë të qytetit të Gostivarit ka pika (elemente) mjaft të përbashkëta me grupet e të folmeve tjera të cilat e karakterizojnë dhe e mbushin të plotën e gjuhës shqipe, e cila me natyrën, larminë dhe rregullat e saj del njëra ndër gjuhët më të vjetra në botë. Një pasuri mjaft e madhe për këtë gjuhë të vjetër janë edhe dialektet, nga të cilat dalin edhe grupet e të folmeve, secila më e veçantë dhe më e mbushur se tjetra, secila më e zëshme dhe më e bukur se tjetra. Do të thotë, ndonëse në tërësinë e kësaj gjuhe njihen vetëm dy dialekte me folës të zëshëm dhe aktivë të saj, duhet përmendur që prej tyre dalin edhe nëndialekte dhe grupe të të folmeve të ndryshme (pa i harruar edhe të folmet individuale), të cilat kur studiohen të vetme, apo kur vihen përballë të tjerave shihen se sa të larmishme janë dhe se sa elemente karakterizuese fshehin brenda vetëve të tyre. Në këtë mes, e folmja e Forinës shihet se në vija krahasimi me grupet e të folmeve tjera ka mjaft pika karakterizuese dhe se secila prej tyre e afron atë me të folmen e një vendi tjetër, pra e afron me vetë folësit e një vendi të caktuar, siç mund të jetë: gegërishtja verilindore, gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja qendrore, gegërishtja e Shqipërisë së Mesme, toskërishtja veriore, toskërishtja jugore, çamërishtja, labërishtja, e folmja e shqiptarëve të diasporës, e arbëreshëve të Italisë, e arbëreshëve të Greqisë, e arbëreshëve të Zarës, e shqiptarëve të Ukrainës, apo e folmja e kelmendasve të Peshterit.

[17] Po aty, f. 239/240.

Referencat

[1.] Çabej. E. 1970. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Prishtinë.
[2.] Dodi. A. 2004. Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
[3.] Frashëri. S. 1979. Vepra 5. Rilindja. Prishtinë.
[4.] Grup autorësh. 2002. Gramatika e gjuhës shqipe 1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
[5.] Grup autorësh. 2002. Gramatika e gjuhës shqipe 2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.
[6.] Hamiti. A. 2005. Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe. Interdiskont. Shkup.
[7.] Haruni. S. 1994. E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit. Flaka e Vëllazërimit.
[8.] Hamiti. A. Qamili. A. 2014. Dialektologjia e gjuhës shqipe. UlShM. Shkup.
[9.] Kadare. I. 2000. Spiritus. Onufri. Tiranë.
[10.] Memushaj. R. 2005. Shqipja standarde. Si ta flasim dhe ta shkruajmë. Botimet TOENA. Tiranë.
[11.] Nesimi. R. 1992. Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme I. Shkup.
[12.] Rrokaj. Sh. 2012. Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme. Arbëria. Tiranë.
[13.] Thomai. J. 1984. Leksikologjia e gjuhës shqipe. Mihail Duri. Tiranë.